



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202100934/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2021

**Lënda :** *Rekomandime për inspektimin e kryer në Komisaratin e Policisë për Kufirin dhe Migracionin, Rinas.*

**Drejtuar :** **Z. Saimir BOSHNJAKU**  
**Drejtor i DVP për Kufirin dhe Migracionin, Tiranë**

**TIRANË**

**Z. Përparim DEMA**  
**Shef i Komisarimit të Policisë për Kufirin dhe Migracionin, Rinas**  
**TIRANË**

**Për dijeni:** **Drejtues i lartë Eduart MERKAJ**  
**Drejtor i Departamentit për Kufirin dhe Migracionin**  
**Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit**

**TIRANË**

*Të nderuar zotërinj,*

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, seksion pranë Avokatit të Popullit, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në Komisaratin e Policisë Kufitare dhe Migracionit, Rinas.

Inspektimi u krye në datën 10.06.2021, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z.Besnik Deda dhe z.Hazbi Selita, me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e procedurave që ndiqen nga punonjësit e policisë kufitare për garantimin e të drejtave të shtetasve shqiptar dhe të huaj në konflikt me ligjin pasi konstatohen si të tillë në pikën e kalimit të kufirit në Aeroportin "Nënë Tereza" Rinas; respektimi i të drejtave të shtetasve shqiptarë që riatdhesohen nëpërmjet operacioneve të rikthimit të detyruar nga policitë e vendeve SCHENGEN, si dhe kthim vullnetar të shtetasve nga këto vende dhe jo vetëm; kushtet e qëndrimit të tyre në ambientet e këtij komisarati ndërtuar sipas kërkesave dhe kritereve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, në procedurën standarde "Trajtimi dhe sigurimi i

*personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, në procedurën standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra në inspektimin e mëparshëm.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t’ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, si më poshtë vijon:

### **Shënime të përgjithshme**

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen dhe trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i inspektimit u takua me Shefin e Komisarariatit për Kufirin dhe Migracionin Rinas z.Përparim Dema, i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në takim grupi i inspektimit u informua mbi masat e marra për përmirësimin e kushteve në ambientin e shoqërimit ku mbahen dhe trajtohen shtetasit që janë në konflikt me ligjin pasi konstatohen nga punonjësit e policisë në pikat e kalimit të kufirit; gjendja dhe kompletimi i ambienteve ku qëndrojnë dhe intervistohen shtetasit shqiptarë të rikthyer në mënyrë vullnetare apo me kthim të detyruar nga vendet pritëse në Republikën e Shqipërisë, për shkak të mosplotësimit të dokumentacionit e të kushteve për hyrjen, praninë apo qëndrimin e rregullt në shtetet pritëse, në zbatim të marrëveshjeve të ripranimit, bashkë me anëtarët e familjes së tyre; si dhe për plotësimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm.

Në vijim, grupi i punës inspektoi ambientin e shoqërimit, ambientet ku intervistohen shtetasit e deportuar apo të riatdhesuar, zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyrohen veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar.

Drejtuesi dhe punonjësit e policisë të komisarariatit, u treguan bashkëpunues gjatë komunikimit dhe inspektimit që zhvilloi grupi i inspektimit në ambientet e këtij Komisaritati. Por bashkëpunimi me institucionin tonë, duhet të shtrihet edhe në hetimin e rasteve individuale, për të garantuar zbatimin e ligjit në përputhje me standarde më të larta të të drejtave të njeriut.

Nga informacioni i drejtuesit të komisarariatit, si dhe nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm, u konstatua se:

1. **Ishte realizuar rekomandimi**, për afishimin në ambientin e shoqërimit të posterave me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe atyre të ndaluar/arrestuar në mjediset e policisë.
2. **Ishte realizuar rekomandimi**, për vendosjen në zyrën e informacionit të regjistrit për evidentimin e të dhënave të personave të shoqëruar, sipas “Model nr.1” të procedurës standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”.

Ndërkohë, u evidentua se nuk ishin zbatuar rekomandimet e mëposhtme:

1. **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për ndërtimin e ambientit të shoqërimit sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, të ndara më vete për personat e rritur, femra dhe të mitur.
2. **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për ndërtimin e ambienteve të nevojshme të punës për punonjësit e policisë së këtij komisariati që zhvillojnë procedurat e intervistimit me shtetasit e riatdhesuar nga vendet e tjera, si dhe për trajtimin dhe qëndrimin ulur të këtyre shtetasve, me kushte të përshtatshme.
3. **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në koridorin dhe në ambientet e tjera të shoqërimit të këtij Komisarati.
4. **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për krijimin më vete të zyrës ku merren në pyetje/intervistohen shtetasit e shoqëruar gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këtë zyrë.

Përsa më sipër, Shefi i Komisarati informoi se, projekti për ndërtimin e godinës të komisarati në bazë të kontratës konçensionare midis shtetit shqiptarë dhe “Tirana International Airport - shpk”, Rinas, **nuk** ishte realizuar. Në këto kushte, shërbimet që ofrojnë punonjësit e policisë kufitare për lehtësimin e hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj, kryheshin ende në ambientet ekzistuese.

Në vijim u informuam gjithashtu se, Komisarati i Policisë për Kufirin dhe Migracionin Rinas, kishte dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit që në vitin 2018, një projekt për ndërtimin e godinës të Komisarati, financim i Ambasadës së Britanisë të Madhe me vlerë 500 mijë paund. Sipas informacionit, DPPSH në datë 13.10.2020 kishte përcjellë me shkresë zyrtare pranë KKRRT-së, kërkesën për miratimin e lejes dhe fillimin e punimeve për ndërtimin e godinës të Komisarati, me të gjitha ambientet për ofrimin e shërbimeve të qytetarëve.

### **Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre**

Ambienti i shoqërimit në Komisaratin e Policisë për Kufirin dhe Migracionin Rinas, **nuk** ishte i ndërtuar sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, ku përcaktohet qartë se, personat e shoqëruar mbahen në ambiente me kushte të ndryshme nga ato që shërbejnë për mbajtjen e personave të arrestuar/ndaluar, me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme për qëndrimin e tyre, si dhe me mjedise të ndara më vete për persona të rritur, femra dhe të mitur<sup>1</sup>.

Ambienti ndodhej në katin e parë të godinës kryesore të komisarati dhe kishte vetëm një dhomë për shoqërimit e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në konflikt me ligjin. Dhoma ishte e bollshme për qëndrim, me dritare e cila lejonte ajrim dhe ndriçim natyral, si dhe kishte ndriçim nga rrjeti elektrik. Ajo ishte e pastër, por ishte e palyer. Dhoma ishte e pajisur vetëm me 4 karrige për qëndrimin ulur të të shoqëruarve në moshë madhore. Përmasat e dhomës ishin 4x4m, me sipërfaqe dhe hapsirë të bollshme për mbajtjen dhe qëndrimin e shtetasve. Kapaciteti i dhomës ishte për mbajtjen e 4 personave.

Në rastin e personave të shoqëruar femra dhe të mitur, ata mbaheshin deri në sqarimin e rrethanave të shoqërimit apo verifikimin e të dhënave të tyre, në një nga ambientet ku kryheshin intervistat me shtetasit shqiptarë të deportuar, e cila ndodhej në godinë më vete në hyrje të institucionit.

<sup>1</sup> Kreu VI, pika 3 e procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Polici së Shtetit”.

Godina e komisariatit, si dhe mjedisi ku ndodhej dhoma e shoqërimit nuk kishin sistem qëndror për ngrohje/ftohje. Gjithashtu mungonin dhe pajisjet elektrike për ngrohje, në periudhën e dimrit. Në afërsi të dhomës së shoqërimit, kishte vetëm një tualet që përdorej nga personeli komisariatit, por dhe për personat e shoqëruar.

Ambienti i shoqërimit nuk kishte zyrë më vete për marrjen në pyetje/intervistimin e të shoqëruarve, sikurse përcaktohet në procedurën standarde, të pajisur me orenditë e nevojshme për specialistët e ndihmës specialistët e policisë si tavolina pune, apo karrige dhe stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Procedura e intervistimit apo marrjes në pyetje të personave të shoqëruar, kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë.

Ambienti i shoqërimit **nuk** vëzhgohej me sistemin e kamerave. Në koridorin e godinës të komisariatit, ishin të vendosura postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në gjuhën shqipe. Ndërsa për shtetasit e huaj, letra e të drejtave ishte përkthyer në 10 gjuhët e huaja më kryesore.

Në kohën e inspektimit, nuk kishte asnjë person të shoqëruar në ambientin e komisariatit, por nga intervista me punonjësën e zyrës së informacionit dhe nga verifikimi i dokumentacionit, u konstatua se, në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse. Ky dokument plotësohej në dy kopje, një kopje e të cilit mbahej nga punonjësi i policisë në zyrën e informacionit.

Nga inspektimi i ambienteve në mjedisin e shoqërimit, nuk u gjetën sende apo mjete të tilla që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve të personave apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë.

Për periudhën Janar - Qershor 2021 në regjistrin e të shoqëruarve ishin evidentuar të dhënat vetëm për 1(një) person të shoqëruar në mjediset e këtij komisariati.

Ndërkohë, për të njëjtën periudhë, në regjistrin e shtetasve të deportuar ishin evidentuar të dhënat për 2 104 shtetas, kryesisht në cilësinë e të deportuarve për shkak të hyrjes në mënyrë ilegale në vendet e BE-së, për kalim të paligjshëm të kufirit nga Franca në Angli, për kalim të afateve të qëndrimit në zonën SCHENGEN, për refuzim të kërkesave për azil, si dhe në përfundim të vuajtjes së dënimit për shkak të veprës penale të kryer në një nga vendet e BE-së.

### **Ambientet e qëndrimit të shtetasve të riatdhesuar**

Komisariati i Policisë Kufitare dhe Migracionit, Rinas, sipas funksionit të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore të krijimit të tij, ka për detyrë edhe kryerjen e procedurave të verifikimit dhe të intervistimit të shtetasve shqiptarë të deportuar, të cilët riatdhesohen në mënyrë periodike nga vendet e BE-së, por edhe nga shtetet e tjera.

Punonjësit e policisë që kryenin intervistimet me shtetasit e deportuar dhe të riatdhesuar nga vendet e BE-së dhe jo vetëm, punonin në dy ambiente të ndara më vete. Njëri ambient

ndodhej brenda territorit të komisariatit dhe ambienti tjetër ndodhej brenda në territorin e Aeroportit “Nënë Tereza”.

Ambienti i cili ndodhej në territorin e komisariatit, përbëhej nga 2(dy) dhoma ku shtetasit e deportuar qëndronin ulur deri në pritje të përfundimit të procedurave nga punonjësit e policisë kufitare. Dhomat ishin të ndara në një ambient për femrat dhe të miturit dhe një dhomë për personat e rritur. Brenda këtij ambienti, ndodhej zyra për intervistimin dhe marrjen e shenjave të gishtave të personave të deportuar. Dhomat ku qëndronin shtetasit e deportuar kishin një sipërfaqe rreth 25 m<sup>2</sup> dhe kapaciteti i tyre ishte për mbajtjen dhe qëndrimin ulur deri në 30 persona.

Dhomat ishin të pajisura me tavolinë pune dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve. Ngjitur me dhomat ndodhej vetëm një tualet. Dritaret e dhomave kishin përmasa të tilla që lejonin hyrjen e dritës natyrale, por nuk kishin ajrim të bollshëm, pasi dritaret ishin të fiksuara dhe nuk hapeshin. Dhomat kishin ndriçim artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik. Në tërësinë e tij, ambienti ishte i vogël dhe nuk ishte i përshtatshëm për të mbajtur shtetasit e deportuar, nisur nga hapësirat e vogla të dhomave, mungesës së ajrimit dhe dritës natyrale, si dhe numrit të vogël të karrigeve që shërbenin për qëndrimin ulur të shtetasve.

Ambienti tjetër, ndodhej brenda në territorin e Aeroportit “Nënë Tereza” dhe shërbente për mbajtjen e qëndrimin e personave të riatdhesuar nga operacionet e rikthimit të detyruar nga vendet pritëse në Republikën e Shqipërisë, të cilët ishin të pajisur me vendime të formës së prerë për kthim të detyruar, për shkak të mos respektimit të rregullave të qëndrimit në hapësirën SCHENGEN, si dhe të refuzimit të kërkesave për azil nga shtete si Franca, Belgjika, Gjermania, Holanada etj. Operacionet për rikthimin e detyruar të shtetasve organizohen nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin pranë DPPSH në bashkëpunim me policitë respektive të vendeve SCHENGEN, si dhe FRONTEx. Theksojmë se, në këto operacione merr pjesë rregullisht dhe një përfaqësues i Avokatit të Popullit, në rolin e monitoruesit kombëtarë.

Ambienti ndodhej në katin e dytë të një ndërtese dhe përbëhej nga 2(dy) dhoma që shërbenin për qëndrimin e personave të rritur dhe një dhomë për qëndrimin e familjarëve me fëmijët e mitur. Në këtë mjedis ndodhej gjithashtu një dhomë për intervistimin e shtetasve të riatdhesuarve, si dhe një tualet i përbashkët. Dhoma e cila shërbente për familjet dhe fëmijët e riatdhesuar, ishte e pajisur me dy divanë për qëndrimin ulur të tyre, si dhe një tualet brenda saj.

Ambienti ishte në pronësi të aeroportit, por ishte marrë me qira dhe administrohej nga Komisariati i Policisë për Kufirin dhe Migracionin Rinas. Shpenzimet për qiranë e këtij ambienti, mbuloheshin nga donacioni i Ambasadës së Britanisë të Madhe në Tiranë.

Sipas procedurës të miratuar, punonjësit e policisë të kufirit pasi regjistronin në librin përkatës personat e deportuar dhe të riatdhesuar, kryenin menjëherë intervistimin e këtyre shtetasve. Më tej, pasi ju merreshin shenjat e gishtave, punonjësit e policisë kryenin verifikimet e këtyre personave nëpërmjet organeve të policisë sipas vendbanimit përkatës. Në përfundim të procedurave, çdo shtetasi i jepej “seti” me dokumente nga vendat që ata vinin, si dhe dokumentet identifikuese bashkë me sendet personale të secilit. Koha e qëndrimit në ambientet e komisariatit të këtyre personave arrinte mesatarisht deri në 4 orë.

Nga verifikimi i regjistrave ku evidentohen të dhënat e këtyre personave, rezultoi se për periudhën Janar – Qershor 2021, në të dyja ambientet ishin trajtuar rreth 2 104 shtetas të deportuar dhe të rikthyer nga vendet SCHENGEN dhe jo vetëm.

Ambientet e qëndrimit të shtetasve të deportuar në këtë godinë, ishin të pajisura me kamera dhe monitoroheshin për 24 orë.

Nga inspektimi i ambienteve të punës së punonjësve të policisë, nuk u konstatuan sende apo mjete që ekspozojnë dhunë apo për kundërveprim ndaj punonjësit të policisë.

### **Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre**

Në Komisarlatin e Policisë për Kufirin dhe Migracionin Rinas, **nuk** kishte ambiente të sigurisë për mbajtjen, trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar dhe dënuarve me vendim të formës së prerë.

Në momentin që këta persona identifikoheshin nga punonjësit e policisë kufitare, drejtuesit e komisarlatit bënin njoftimin dhe kryenin menjëherë transferimin e tyre për në dhomat e sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë apo për në ambientet e dhomave të sigurisë të drejtorive/komisariateve vendore të tjerë të Policisë së Shtetit.

### **Sjellja e punonjësve të policisë gjatë komunikimit me qytetarët**

Gjatë kohës së inspektimit në këtë komisarlat u monitorua edhe sjellja e punonjësve të policisë gjatë komunikimit me qytetarët, kryesisht me shtetasit shqiptarë të riatdhesuar nga vendet e tjera, si dhe me shtetasit shqiptarë dhe të huaj që hynin e dilnin në Aeroportin “Nënë Tereza” Rinas. Nga monitorimi dhe pyetja e disa prej qytetarëve që hynin dhe dilnin nga aeroporti u konstatua se, punonjësit e policisë komunikonin në mënyrë korrekte dhe me etikë, duke i trajtuar me respekt e dinjitet njerëzor qytetarët.

Në kohën e inspektimit, grupi i monitorimit nuk gjeti shtetas në ambientin e shoqërimit dhe në ambientet e intervistimit të shtetasve të deportuar apo të riatdhesuar nga operacionet e përbashkëta me FRONTEX, që mund të intervistoheshin në lidhje me procedurat e ndjekura dhe sjelljen e punonjësve të policisë. Por, nga informacioni i drejtuesit të komisarlatit, u informuam se këtyre personave në momentin e dorëzimit të dokumentacionit, të pasaportës dhe sendeve të tyre personale, ju jepej dhe një kopje e proces-verbalit të mbajtur nga punonjësi i policisë për secilin person të rikthyer. Aty pasqyrohen shkaqet e kthimit dhe kohëzgjatja e penalteteve, si rezultat i shkeljeve të rregullave Shengen nga personi i kthyer konform nenit 109/1/f dhe 109/5 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”<sup>2</sup>.

Gjatë vitit 2020, Institucioni i Avokatit të Popullit në kuadër të operacioneve për riatdhesimin e shtetasve shqiptarë, që organizohen nga FRONTEX në bashkëpunim me Departamentin e Kufirit dhe Migracionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për shkak të masave parandaluese të sëmundjes infektive COVID-19 dhe kufizimit të fluturimeve të ndërsjellta me vendet e BE-së, nga 25 operacione të zhvilluara, MKPT

---

<sup>2</sup>Neni 109/1/f “Punonjësi i policisë bën shoqërimin e personave në ambientet e Policisë ose institucionin urdhërdhënës në kushtet dhe rastet e mëposhtme: f) për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose ekstradimit.

Neni 109/5 “Punonjësi i policisë, dokumenton në proces-verbal veprimet e kryera me personin e shoqëruar. Procesverbali nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi i shoqëruar. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit të shoqëruar.”

ka qenë pjesë e grupit të monitorimit në 10 operacione të riadhesimit vullnetar e të detyruar të shtetasve shqiptarë nga vendet e BE-së dhe konkretisht Francës.

Përfaqësuesit e MKPT-së në këto operacione, kanë zhvilluar intervista me shtetasit shqiptarë para nisjes dhe gjatë udhëtimit në bordin e avionit, në lidhje me kushtet e trajtimit në qendër, gjendjen psikologjike dhe shëndetësore të tyre, njohjen apo jo me vendimin për rikthimin e detyrueshëm apo dëbimin e tyre, si dhe nëse janë të informuar për procedurat e shoqërimit të detyruar gjatë imbarkimit dhe fluturimit të tyre për në atdhe.

Nga intervistat, shtetasit shqiptarë **nuk** kanë ngritur probleme apo shqetësime për keqtrajtime ndaj tyre nga policitë e vendeve e vendeve pritëse. Ankesat e tyre kanë konsistuar, në mungesën e informacionit dhe kohën e pamjaftueshme në dispozicion, për të apeluar pranë organeve të shteteve respektive, të vendimit për largimin apo dëbimin e detyruar nga vendet e BE-së.

### **Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar si dhe trajtimi i tyre.**

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarlatin e Policisë Kufitare “Nënë Tereza” Rinas, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr.1”, sikurse përcaktohet procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019.

Në zyrën e informacionit, punonjësi i shërbimit kishte një regjistër ku hidheshin të dhënat për personat e shoqëruar, i cili ishte sipas “Model nr.1” të lartëpërmendur. Ky regjistër përmbante disa nga rubrikat kryesore dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se:

Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 4 orë. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë

Në zyrën e informacionit, ishte dhe një regjistër për evidentimin e të dhënave të personave të ndaluar/arrestuar të cilët janë të shpallur në kërkim, për shkak vendimit të formës së prerë nga gjykata. Në këtë regjistër, evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve të kryera nga punonjësit e komisarlatit, ora e ndalimit, ora e njoftimit të drejtorisë/komisariatit vendor të policisë që ka shpallur në kërkim, si dhe ora e transferimit të këtyre personave nga ky komisarlat. Regjistri ishte i plotësuar sipas rubrikave dhe ishte i sekretuar.

Ndërkohë, u konstatua se në këtë Komisarlat kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por për periudhën e inspektimit nuk kishte asnjë ankesë apo kërkesë të regjistruar.

### **Ambientet e intervistimit**

Në Komisarlatin e Policisë “Nënë Tereza” Rinas oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e punës së tyre, pasi mungonte një ambient i veçantë për intervistimin/marrjen në pyetje të shtetasve, i cili të ishte i monitoruar me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale me këta shtetas.

Ndërsa, ambjentet ku mbahen dhe trajtohen shtetasit e deportuar dhe të riatdhesuar, ishin të monitoruara me sistemin e kamerave.

Avokati i Popullit, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare, e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.<sup>3</sup>

Nga monitorimi që ju bë zyrave të punonjësve të policisë, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

### **Ndihma juridike dhe psikologjike**

Gjatë inspektimit, u intervistuan punonjës të policisë që kryenin veprime procedurale me shtetas të shoqëruar apo të ndaluar/arrestuar ku rezultoi se, në rastet kur këta persona kërkonin ndihmë juridike nga avokat mbrojtës, në pamundësi financiare për të marrë këtë shërbim, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat kryesisht.

Në rastet kur personat e deportuar ishin të mitur në konflikt me ligjin, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë. Ndërsa psikologu sigurohej nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë.

Ndërkohë, u konstatua se në këtë Komisarjat, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, lidhur me plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Gjatë inspektimit u konstatua se, në korridorin dhe brenda në dhomën e shoqërimit të Komisarjati, ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat

---

<sup>3</sup> “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohen në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]



*dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ku parashikohet midis të tjerash se: “Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca:  
b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.”,*

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin e ambientit të shoqërimit në Komisarriatin e Policisë Kufitare dhe Migracionit në Rinas, sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe procedurës standarde të miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, me ambiente të ndara më vete për personat e rritur, femra dhe të mitur, me kushte dhe mjedise të përshtatshme e dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrimin ulur të personave. (*Rekomandim i përsëritur edhe në inspektimin e mëparshëm*).
2. Marrjen e masave të nevojshme, për ndërtimin e ambienteve të përshtatshme për mbajtjen, qëndrimin dhe zhvillimin e procedurave të intervistimit me shtetasit shqiptarë të riatdhesuar apo të deportuar nga vendet e BE-së dhe vendet e tjera, si dhe me kushte pune të nevojshme për punonjësit e policisë së këtij komisarriati, sipas standardeve bashkëkohore.
3. Marrjen e masave të nevojshme, për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në koridorin dhe në ambientet e tjera të shoqërimit të këtij Komisarriati.
4. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e zyrës më vete ku merren në pyetje/ intervistohen shtetasit e shoqëruar gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këtë zyrë.
5. Marrjen e masave të menjëhershme, për vendosjen e një psikologu pranë këtij komisarriati, për të parë dhe evidentuar rastet e fëmijëve të deportuar, si dhe për të analizuar riskun e tyre me kthimin në Shqipëri.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.*

**KOMISIONER**

**Ermonela XHAFJA**